



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:097792

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06237767

PPP.nr.02/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qomega, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores K, kundër debitorit A.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhërit të përmbaruesit privat Gj.R në Gjakovë, P.nr.153/2021 të datës 22.03.2021, me datë 01.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET prapësimi i debitorit A.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, i paraqitur kundër urdhërit të përmbaruesit privat Gj.R në Gjakovë P.nr.153/2021 të datës 22.03.2021, si i pabazuar.

II. MBETET NË FUQI urdhri i përmbaruesit privat Gj.R në Gjakovë P.nr.153/2021 të datës 22.03.2021, me të cilin është caktuar përmbarimi, për borxhin prej 493,53 (katërqind e nëntëdhjetë e tre Euro e pesëdhjetë e tre cent) dita e paraqitjes së propozimit, me datën 22.03.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

III. Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

A r s y e t i m

Sipas propozimit të kreditores K, përmbaruesi privat Gj.R në Gjakovë, ka caktuar përmbarimin sipas urdhrit P.nr.153/2021 të datës 22.03.2021, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, kundër debitorit A.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të borxhit në shumën e përgjithshme prej 493,53 (katërqind e nëntëdhjetë e tre Euro e pesëdhjetë e tre cent), lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë elektrike, për periudhën nga data 25.02.2020 e deri me datë 11.02.2021.

Kundër urdhërit me të cilin është caktuar përmbarimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kontestuar urdhërin për caktimin e përmbarimit, me arsyetim se po të shikohen transaksionet e konsumatorit – ekstrakti nga librat afariste, rezulton se debitori nuk e ka këtë shumë pa paguar, apo po të shikohet gjendja që ai si klient i ka kreditorit vetëm shumën prej 187.93 €, si dhe në parashkrim të kërkesës.

Kreditorja, brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazë, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 25.02.2020 deri me datën 11.02.2021, në shumën prej 493,53 €. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë si të pa bazë.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhërit për caktimin e përmbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditores, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhë në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e dokumentit të besueshëm ekstraktit nga librat afariste të datës 19.03.2021 vërtetoi faktin se debitori i ka mbetur borxh kreditores shumën prej 493,53 (katërqind e nëntëdhjetë e tre €uro e pesëdhjetë e tre cent), në emër të marrjes së shërbimeve të energjisë elektrike, për periudhën prej datës 25.02.2020 deri me datën 11.02.2021. Pra, dokumenti mbi të cilin pala kreditore e mbështet propozimin për përmbarim përbën dokument të besueshëm, në përputhje me nenin 29 par. 1 nën par. 2 të LPP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore shprehimisht theksohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”. Kështu, në nenin 360 par. 1 pika 1.1. të LMD-së, përcaktohet që “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, parashkruhen pas një (1) viti”. Ndërsa në par. 2 të këtij neni parashihet që “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Ndërsa sa i përket borxhit për periudhën prej datës 25.02.2020 deri me datën 11.02.2021, gjykata gjeti se për këtë periudhë kohore është ndërprerë rrjedha e parashkrimit për shkak të parashkrimit të propozimit për përmbarim të ushtruar nga kreditori, ashtu që e la në fuqi pjesën e urdhrin për përmbarim sa i përket shumës prej 493,53 euro. Sipas vlerësimit të gjykatës, baza e ndërprerjes së parashkrimit parashihet në nenin 369 të LMD-së, sipas të cilit “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.” Ndërsa sa i përket periudhës kohore të përfshirë në ndërprerjen e parashkrimit e për të cilën gjykata ka lënë në fuqi urdhrin për përmbarim, gjykata vlerëson se ka vepruar sipas nenit 360 par.2 të LMD-së, sipas të cilit “Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”, dhe për këtë arsye është përfshirë i tërë viti 2021 e deri më datën 11.02.2022.

Pretendimet e debitorit në prapësim, se në periudhën nga data 25.02.2020 deri me datën 11.02.2021, në shumën prej 493.53 €, gjykata nuk e morri për bazë ngase pagesa e kështit e ndërpret parashkrimin për të gjitha kërkesat për të cilat nuk ka skaduar afati 1 vjeçar por jo edhe për kërkesat për të cilat nga momenti i pagesës kanë kaluar mbi 1 vit sipas afatit të përcaktuar ligjor sepse këto kërkesa nuk përfaqësojnë borxh unik por janë kërkesa të specifikuar mujore.

Andaj gjykata, ka ardhur në përfundim se pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, nuk janë bazë e mjaftueshme, e as pengesë për lejimin e përmbarimit në rastin konkret, lidhur me propozimin e kreditorit për borxhin, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit.

Nga të lartcekurat, kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par.1 pika 1.3 lidhur me nenin 73 par.2 dhe 3 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:097792
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06237767

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.02/2024, me datë 01.10.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gj y q t a r i
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.